



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 529/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të kërcënimit gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

I MIRATOHEN si të bazuar ankesat më nr. 529 dhe 537 të datës 13.12.2010, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

II Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 4900 (katërmijëntëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në buxhetin e Republikës së Kosovës.

III Vesel Krasniqi, i lindur me 03.03.1973, nga fshati Banjë Komuna e Malishevës, në cilësinë e komisionarit në Vendvotimin 3032A/04D, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe **Behlul Limaj** i lindur me 03.12.1965, nga fshati Banjë Komuna e Malishevës, iu ndalohe për 6 (gjashtë) vite, të marrin pjesë në zgjedhje të mbajtura nën autoritetin e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, nga plotfuqishmëria e këtij vendimi.

A r s e y e t i m

PZAP, ka pranuar dy ankesa më datë 13.12.2010 më nr. 529 dhe 537 nga subjekti politik LVV.

Në ankesën më nr. 529 pretendohet se Burim Berisha, në cilësinë anëtarit të Këshillit të Vendvotimit (KVV) 3032a/4, në fshatin Banjë komuna e Malishevës nga subjekti politik LVV, është kërcënuar me fjalët, “ *se ne e dimë që je i vetmi djalë dhe e di çfarë të gjen, a e dinë se je në Banjë*”. Sipas parashtresës së ankesës kjo ka ndodhur nga Vesel Krasniqi në cilësinë e komisionarit në Vendvotimin 3032A/04D, nga radhët e subjektit politik PDK, po ashtu në ankesë potencohet se gjatë numërimit të votave nga i njëjti është kërcënuar më likuidim. Që është në kundërshtim më nenin 34 paragrafët 1 dhe 2 të LZP-së.

Në ankesën më nr. 537 pretendohet se Hazir Krasniqi në cilësinë vëzhguesit në Qendrën e Votimit (QN) 3032a, në fshatin Banjë komuna e Malishevës nga subjekti politik LVV, është sulmuar fizikisht nga Vesel Krasniqi në cilësinë e komisionarit në Vendvotimin 3032A/04D dhe nga simpatizantët e subjektit politik PDK. Në ankesë po ashtu theksohet se vëzhguesi Hazir Krasniqi nga subjekti politik LVV është kërcënuar më vrasje nga Behlul Limaj, parashtresës i ankesës konsideron se është bërë shkelje e nenit 2 paragrafi 8 pika (e) të Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009.

Në deklaratën e dhënë në polici më datë 13.12.2010, Vesel Krasniqi në cilësinë e komisionarit në Vendvotimin 3032A/04D në fshatin Banjë komuna e Malishevës nga radhët e subjektit politik PDK, potencohet se ia ka tërhequr vërejtjen Hazir Krasniqit në cilësinë e vëzhguesit nga radhët e subjektit politik LVV tërë kohen për tu sjell mirë sepse i provokonte votuesit. Mirëpo as që donte të dëgjonte për vërejtjet e marra.

Në deklaratën e dhënë në polici më datë 13.12.2010, Behlul Limaj potencon se derisa ishte duke qëndruar në restorantin e tij "Kështjella", dikush ka lajmëruar se të shkolla e fshatit Banjë, ka ndodhur një rrahje mes disa personave. Pastaj i dyshuari ka shkuar të shkolla, por sipas tij nuk ka vërejtur asgjë të jashtëzakonshme, përveç që e ka vërejtur një veturë duke u larguar dhe dikush i ka thanë të dyshuarit se ata që po largohen janë që kanë shkaktuar probleme. I dyshuari ka filluar të vrapoj për ta ndaluar atë veturën por duke vrapuar është rrezuar dhe e kanë kapur policia, pastaj e kanë dërguar në stacionin policor në Malishevë. I dyshuari mohon të këtë pasur ndonjë mjet të dyshimtë me vete.

Në Kallëzimin Penal të Policisë së Kosovës më nr.2010-GE-644 të datës 13.12.2010, theksohet së: " Të dyshuarit Vesel Krasniqi dhe Hazir Krasniqi pohojnë se gjatë gjithë procesit të votimit kanë pasur mosmarrëveshje mes veti njëri në cilësinë e komisionarit të PDK-së ndërsa tjetri në cilësinë e vëzhguesit të subjektit politik LVV, ku pas përfundimit të numërimit të fletëvotimeve i dyshuari Hazir Krasniqi pas hyn në veturën e tij duke e pritur një komisionar të subjektit të vet, i njëjti pohon se është sulmuar nga Vesel Krasniqi dhe nga shtatë persona tjerë, ndërsa aty kishin ndërhyrë policia për të vënë situatën nën kontroll, ku gjatë intervenimit të policisë aty kishte ardhur i dyshuari Behlul Limaj i cili ishte nisur në drejtim të dyshuarit Hazir Krasniqi, ndërsa kishte nxjerr nga brezi një armë pistoletë por më ndërhyrjen e policisë situata ishte vënë nën kontroll, i dyshuari është arrestuar ndërsa arma e llojit pistoletë më nr. Serik 1-224487 cal. 7.62 dhe shtatë fishek adekuat për këtë pistoletë janë sekuestruar, në këtë përleshje lëndime trupore ka pësuar i dyshuari Hazir Krasniqi, siç edhe në raportin e mjekut nr. 6800/10".

KODI I MIRËSJELLJES PËR SBJEKTET POLITIKE, MBËSHTETËSIT E TYRE DHE KANDIDATËT

Frikësimi dhe Dhuna Gjatë Procesit Zgjedhor

Neni 34 paragrafët 1 dhe 2 të LZP-së parashohin se:

34.1 Përdorimi ose kërcënimi me përdorim të dhunës se çfarëdo lloj nga subjekti politik, anëtarët, mbështetësit ose kandidatët e tyre, ndalohet rreptësisht.

34.2 Asnjë subjekt politik ose kandidatët nuk inkurajojnë, mbështesin ose miratojnë dhunën, kërcënimet më dhunë ose kanosje, gjatë procesit zgjedhor. Secili subjekt politik i informon anëtarët dhe mbështetësit e tij për nevojën për të shmangur një sjellje të tillë.

Sanksionimi për shkeljet e parimeve të këtij Kodi

Neni 38 paragrafi 1 i LZP-së dhe neni 8 paragrafi 1 i Rregullës Zgjedhore nr. 11/2009, parasheh;

Shkelja e njërit nga këto nene të kodit të Sjelljes, në rastet kur këto shkelje nuk kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve, konsiderohet shkelje administrative dhe e dënueshme me gjobë sikurse është përcaktuar nga PZAP-i.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

120.1 c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Neni 120 paragrafi 3 pika (d) i LZP-së, parasheh se:

120.3 d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesat janë te bazuar.

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Në rastin konkret PZAP ka marrë si rrethanë renduese faktin se shkelja ka të bëjë më veprimet e ndaluar të parapara në nenin 34 paragrafët 1 dhe 2 të LZP-së.

PZAP duke u bazuar në thëniet nga ankesat si dhe nga Kallëzimi Penal i Policisë me nr.2010-GE-644 të datës 13.12.2010, vlerësoj pretendimet nga ankesat janë të bazuara ashtu që ndaj Vesel Krasniqit dhe Behlul Limaj, vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi.

Prandaj nga arsyet lartcekura e më qëllim të evitimit të shkeljeve të pretenduar në ankesat dhe në pajtim më dispozitat e lartcekura ligjore, e në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 529/2010 më datën 16.12.2010

